



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 10 -2009
Prishtinë, më 27 mars 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Bajram Kosumi, Kolë Berisha
Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj dhe Adem Hajdaraj.

Munguan: Branisllav Grbiq dhe Selvije Halimi.

Të pranishëm: Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti, Reshit Gashi – KDI,
Lumnije Murati – ZPRK, Xhavit Gaxherri dhe Blendi Gashi - *Bota Sot*.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 16 dhe të 23 marsit 2009;
3. Shqyrtimi i propozimvendimit për formimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – I përshëndeti të gjithë të pranishmit, i falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit dhe i njoftoi të pranishmit për rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 16 dhe të 23 marsit 2009

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje eventuale për procesverbalet.

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimvendimit për formimin e Komisionit për Provimin të Jurisprudencës

Kryetari - Diskutoi për propozimvendimin për formimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës. Shtoi se kjo çështje ishte paraqitur disa herë në Komision. Kam biseduar edhe me ministren e Ministrisë së Drejtësisë, znj. Nekibe Kelmendi. Për këtë çështje ajo është e gatshme të vijë në mbledhjen e Komisionit, por, brenda mundësive, kërkon nga Komisioni ta shtyjë mbledhjen pas orës 13:00, sepse deri në atë kohë është në mbledhjen e Qeverisë.

Në propozimvendimin e Ministrisë së Drejtësisë edhe kësaj radhe është futur Ruzhdi Berisha, i cili edhe dy herë më parë nuk i kishte plotësuar kushtet për anëtar të Komisionit për Provimin e Jurisprudencës. Më duhet t'ju njoftoj se edhe kandidati tjetër, z. Robert Muharremi, anëtarë i propozuar i këtij komisioni, ka dhënë dorëheqje.

Ibrahim Makolli - Ministria e Drejtësisë, propozuese e listës së kandidatëve për provimin e jurisprudencës, po mendon se ata që i propozon ajo, duhet të rekomandohen për në Kuvend edhe nga Komisioni. Ligji për Provimin e Jurisprudencës nuk është i mirë, sepse nuk ofron edhe mundësi tjera, si p.sh: dy kandidatë për një pozitë. Po të veprohej kështu do të ishte më lehtë, sepse mundësia për t'i zgjedhur kandidatët do të ishte më e madhe.

Armend Zemaj - Mendoj se kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet për një nga mbledhjet e ardhshme të Komisionit. Në të duhet të jetë e pranishme edhe ministrja e Ministrisë së Drejtësisë, znj. Nekibe Kelmendi. Ai foli edhe për rëndësinë e reformimit të sistemit gjyqësor dhe për numrin e madh të kandidatëve, që presin ta japin provimin e jurisprudencës. Propozimi i Ministrisë së Drejtësisë duhet të procedohet me arsyetimin se numri i kandidatëve, të cilët ka kohë që po presin ta japin këtë provim, është tejet i madh.

Adem Salihaj - Kandidati Ruzhdi Berisha nuk i plotëson kushtet. Kjo është hera e tretë që propozohet ky kandidat edhe pse nuk i plotëson kushtet. Mendoj se nuk ka kuptim ta

rekomandojmë të njëjtin kandidat, sepse dalim joseriozë. Tash e dimë se edhe Robert Muharremi ka dhënë dorëheqje. Sipas mendimit tim nuk është mirë të kandidohet as Vjosa Osmani, sepse është duke punuar si këshilltare në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Bajram Kosumi - Duhet t'i kemi parimet e njëjta për të gjithë kandidatët. Ndryshe nuk bën të vepron.

Kryetari – E lexoi edhe njëherë nenin 7.6 të Ligjit për provimin e jurisprudencës, në të cilin saktësohen kushtet dhe kriteret për anëtarë të Komisionit të Provimit të Jurisprudencës. Komision po ia dërgon një shkresë Ministrisë së Drejtësisë në të cilën thuhet se sipas Ligjit për provimin të jurisprudencës, kandidati duhet t'i ketë pandërprerë 10 vjet përvojë pune si gjyqtar i lëndës. Këtë kriter nuk e plotëson Ruzhdi Berisha. Meqë Robert Muharremi ka dhënë dorëheqje duhet të zëvendësohet me një tjetër. Komisioni pati shqetësime që u shfaqën në diskutimet edhe për kandidaturën e Vjosa Osmanit.

4. Të ndryshme

Ibrahim Makolli - I njoftoi anëtarët e Komisionit për planin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit penal për të mitur dhe e paraqiti me shkrim orarin e takimeve me të gjitha institucionet e rëndësishme që ndërlidhen me zbatimin e Ligjit penal për të mitur.

Takim i parë, me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht me sekretarin e përhershëm, është paraparë të mbahet më 31. 03. 2009, në orën 10: 00, në lokalet e kësaj ministrie.

E hartoi stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni